

Mbi bazën e nenit 55 paragrafi 1 nga Ligji për organizatë dhe punë të organeve të drejtorive shtetërore (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/00 dhe 44/02) dhe nenit 24 dhe 26 nga Ligji për arsim fillor (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 dhe 51/07) ministri i arsimit dhe shkencës solli program mësimor për lëndën zgjedhore *aftësi për jetesë* për klasën e VI të arsimit bazë tetëvjeçar, përkatësisht për klasat e VII, VIII ose IX për arsimin bazë nëntëvjeçar.

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
BIRO PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT**

**PROGRAM MËSIMOR**

**Lëndë zgjedhore**

**ARSIM FILLOR**

**AFTËSI PËR JETESË**

## **1. Hyrje**

Me mësimin e lëndës *Aftësi për jetesë* nxënësit fitojnë njohuri dhe aftësi me të cilat do ti kënaqin nevojat e tyre psikofizike, ekonomike, sociale dhe estetike.

Ato aftësi do u shërbejnë nxënësve në shtëpi, në shkollë dhe në rrethinë.

Theksi në këtë lëndë zgjedhore është vendosur mbi fitimin e njohurive dhe aftësive që kanë të bëjnë me zgjedhjen, përgatitjen dhe kulturën e ushqimit dhe veshjes, mbrojtjes personale dhe kolektive në raste të llojeve të ndryshme të kanosjes, si edhe njohuri dhe aftësi bazë të nxënësve si konsumatorë.

Lënda mësimore *Aftësi për jetesë* mësohet si lëndë zgjedhore në klasën e VII, VIII dhe të IX me fond javor pre 2 orësh, përkatësisht 72 orë gjatë vitit mësimor.

### **Shënim:**

Në pajtim me dinamikën për vendosjen e edukimit dhe arsimit bazë nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit në klasën e VI të shkollës tetëvjeçare bazë nga viti mësimor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII, VIII ose IX të arsimit bazë nëntëvjeçar.

## 2. QËLLIME TË ARSIMIT PËR KLASAT E VII, VIII DHE IX

Nxënësi/nxënësj:

- të përfshihet në mënyrë aktive në problemet dhe situatat e përditshme në shtëpi, shkollë dhe në rrethinë nëpërmjet veprimeve dhe aktiviteteve të paramenduara;
- të fitoj njohuri për mbajtjen dhe përgatitjen e ushqimit;
- të aftësohet të përgatis ushqime të thjeshta të shëndosha për veten dhe për anëtarët e familjes së vet, ta vendos pajisjet dhe ushqimin në çdo vakt;
- të fitoj njohuri për mënyrën e përgatitjes, mbajtjen dhe përdorimin e veshjes;
- të aftësohet të zgjedh dhe të vesh veshje dhe këpucë që përshtaten me raste dhe kushtet kohore dhe me nevojat e tij/ të saj, ta mirëmbajë veshjen me përdorimin e mjeteve përkatëse;
- të zhvillojë shprehje për ndërrimin e veshjeve dhe këpucëve në varësi nga rastet dhe rrethanat, llojin e aktiviteteve etj;
- të aftësohet për korrigjime të vogla në veshjen e vet (të qep kopsë, të rregulloj tegel, të qep emblemë, aplikim etj);
- të fitojë njohuri në zgjedhjen e rrezikut dhe fatkeq;si elementare;
- të aftësohet të gjendet në situata të cilat rrezikojnë sigurinë e tij/ të saj;
- të aftësohet të veprojë sipas rregullave për siguri në shkollë dhe jashtë saj;
- të aftësohet ti zbuloj burimet e rrezikut dhe sigurisë të kërcënuar në shtëpi, në shkollë dhe në rrethinën e jetesës;
- të aftësohet të identifikojë situata të lëndimit ose gjendje dhe të reagojë në mënyrë përkatëse;
- të fitojë njohuri për rolin e konsumatorit dhe shfrytëzuesit të shërbimeve;
- të aftësohet të bëj seleksionim dhe të përcaktojë prioritete të nevojave të veta gjatë blerjes dhe të mbajë evidencë personale për paratë e shpenzuara;
- të aftësohet ti lexojë simbolet për mënyrën e përkujdesjes dhe afatit të vlefshmërisë të produkteve të caktuara;
- të aftësohet të kërkojë llogari fiskale për çdo produkt të blerë.

### 3. QËLLIME KONKRETE

Tema: USHQIMI			
Qëllime	Përmbajtje	Terme	Aktivite dhe metoda
Nxënësi/nxënësja  - Të fitoj aftësi për pastrim dhe mirëmbajtje të ushqimit	- Mënyra për pastrimin e ushqimit Mënyra për mbajtjen e ushqimit të freskët dhe të pastër	Paketim Magazininim Konservim Pasterizim Ngrirje	- Larjen e frutave dhe perimeve sezonale në kuzhinën e shkollës. - përgatitjen dhe paketimin e perimeve sezonale dhe/ose frutave për ngrirje në kuzhinën e shkollës. - hulumtimin e procesit të pasterizimit dhe konservimit – përgatitjen e ushqimit për dimër (vajtje në fabrikë lokale ose intervistë me prindër, të afërm, fqinj), dokumentim të procesit. - Përgatitjen e foto historisë, gazetë murri, për procesin e pasterizimit dhe konservimit.
- të aftësohet për praktikumin e mjeshtërive bazë të kuzhinës	- mjeshtëri bazë për përgatitjen e ushqimit - pajisje të nevojshme për mjeshtëritë bazë të kuzhinës.	Qërim Prerje Trazim Përgatitje brumi	- demonstrim praktik dhe paraqitje e mjeshtërive bazë për përgatitjen e ushqimit ( qërim, prerje, trazim, përgatitje brumi) në kuzhinën e shkollës (ose sipas kushteve të shkollës dhe resurseve në bashkësinë lokale – në klasë, në kopshtin lokal etj.).

<p>-të dijë të përdor receta për përgatitjen e ushqimit</p>	<p>- elemente të nevojshme të recetave - matje të përbërësve - përgatitjen e recetës për ushqimin dhe /ose pijen e preferuar</p>	<p>Përbërës të recetës Njësi matëse</p>	<p>- përvetësim praktik i aftësive për matjen e produkteve të ndryshme (të lëngshme, të forta) në njësitë matëse të ndryshme (lidhje me ndonjë prej laboratorëve shkollorë)- metodë punëtorie. - përgatitjen e listës me këshilla nga recetat shtëpiake -përgatitjen e fletores me receta të ushqimeve dhe pijeve të preferuara të nxënësve.</p>
<p>- të fitojë aftësi për praktikumin e mënyrave bazë të përgatitjes së ushqimit</p>	<p>- mënyra bazë të përgatitjes së ushqimit -rregulla bazë gjatë mënyrave të ndryshme të përgatitjes së ushqimit</p>	<p>Pjekje Skuqje Zierje e ngadalshme Zierje</p>	<p>-përdorimin e librave për gatim dhe TV emisioneve për njohjen me mënyrat e përgatitjes së ushqimit. -përpunimin e kuzhinierit në klasë me ushqimet tradicionale nga rajoni. - përgatitjen e sandviçit personal, zëmrës (punëtori). -përgatitjen e vakteve të thjeshta me përdorimin e mënyrave bazë për përgatitjen e ushqimit në kuzhinën e shkollës (ose sipas kushteve në shkollë dhe resurseve në bashkësinë lokale – në klasë, në kopshtin lokal, vizitë në ndonjë shtëpi etj.).</p>
<p>- të fitojë aftësi për vendosjen dhe dekorimin e ushqimit</p>	<p>-pajisje bazë për ngrënie dhe shërbim që duhet të vendoset në tavolinë - radha dhe pozicioni i vendosjes të çdo pjese të pajisjeve sipas përmbajtjes së vaktit</p>	<p>Pajisje për ngrënie Vendosje e tavolinës Dekorim i ushqimit</p>	<p>-shpjegim dhe demonstrim i vendosjes së thjeshtë të ushqimit (ftesë e hotelierit – kamerierit ose kuzhinierit) – punëtori në kuzhinën e shkollës ose në klasë. - dekorimin e ushqimeve të caktuara (supë, sallatë, kulaç) – bisedë dhe përgatitje praktike në kuzhinën e shkollës ose në klasë.</p>

	- dekorimin e ushqimit në kuzhinën tradicionale dhe bashkëkohore		
- të fitojë kulturë në të ngrënë	- bonton gjatë ngrënies (sjellje në restorant) - sjellje gjatë ngrënies në kultura të ndryshme	Kultura e të ngrënit	- prezantim dhe bisedë për bon-ton gjatë ngrënies. - dramatizimin e skenarëve dhe situatave të ndryshme për (mos)përdorimin e kulturës së të ngrënit (luajtjen e roleve). - vizatimin e stripit për sjellje të ndryshme gjatë ngrënies në kulturat dhe traditat e ndryshme. - shikimin bashkërisht të filmit me elemente të kulturës së të ngrënit në vende të ndryshme.

Tema: VESHJE

Qëllime	Përmbajtje	Terme	Aktivitete dhe metoda
Nxënësi/nxënësjja  - t'i dallojë qimet tekstile bazë - t'i dijë simbolet për llojet e ndryshme të lëndëve të para tekstile në etiketat e veshjes	- qime tekstile dhe prejardhja e tyre (natyrale dhe artificiale) - simbole për shënimin e llojeve të ndryshme të lëndës së parë tekstile në etiketat e veshjes	Qime tekstile Natyrale (bimore-pambuk, mëndafsh, konop, len) kafshësh – lesh, kashmir, angorë Artificiale (sintetike – poliestër, akrilik, najlon, llastik)	- Prezantim të llojeve të ndryshme të qimeve tekstile (pambuku, leshi, mëndafshi, najloni, konopi...) - Vizitë e dyqanit për materiale dhe lëndë të parë tekstile. - Përpunim i posterëve me llojet e ndryshme të lëndës së parë tekstile dhe simbolet e tyre.

<p>- të bëj dallim midis llojeve të ndryshme të materialeve tekstile</p> <p>- të njihet me aftësitë bazë për mënyrat e përpunimit të materialeve tekstile</p>	<p>-materiale tekstile (pëlhura, materiale të thurura dhe të punuara) dhe mënyra e përpunimit</p> <p>- thurja dhe teknika të thurjes</p> <p>- tjerje me vegël</p>	<p>Tjerje</p> <p>Thurje</p> <p>Furkë</p>	<p>- Prezantimi i materialeve të ndryshme tekstile – të thurura, të tjera dhe materiale me furkë</p> <p>- përpunim kolazhi nga materiale të ndryshme tekstile</p> <p>- punimin e gërshetave me tre lidhje</p> <p>- thurje me shtiza</p> <p>- Tjerje në vegël (maketa)</p>
<p>- të dallojë stile të veshjeve</p> <p>- të ketë stil të vetin të veshjes</p>	<p>- trende mode dhe industri e modës</p> <p>- Stile të të veshurit – stil personal</p>	<p>Modë</p> <p>Trende</p> <p>Stile të të veshurit (sportiv, modern, varësisht nga muzika ose subkulturë tjetër, varësisht nga religjioni, tradita)</p> <p>Veshje tradicionale</p>	<p>- diskutim dhe prezantim të materialeve për stile të ndryshme të të veshurit</p> <p>- përpunim i portofolit për stilin personal të veshjes (me fotografi, vizatime, shënime)</p> <p>Debat për modën, trendet e të veshurit dhe përfitimet dhe dëmet nga industria e modës sot.</p> <p>Hulumtim të mënyrave të të veshurit (sot dhe në të kaluarën, në Maqedoni dhe në vende dhe kultura të tjera)</p>
<p>- të njoh, dalloj dhe zgjedh pjesë të veshjes varësisht nga dedikimi i tyre</p> <p>- të bëj prioritete gjatë zgjedhjes së veshjes</p>	<p>-garderobi im – pjesë të veshjes sipas dedikimit dhe nevojës</p> <p>- si e vesh veshjen time?</p> <p>- veshja dhe shëndeti</p>	<p>Veshje e poshtme</p> <p>Veshje e sipërme</p> <p>Këpuçë</p> <p>Shtojca të veshjes</p> <p>Veshje dimri, vere</p> <p>Me dedikim ( për sport, veshje mbrojtëse, uniforma...)</p>	<p>-bëhet listë e garderobit personal dhe diskutohen pjesët e veshjes sipas dedikimit dhe nevojave</p> <p>- bëhet punëtori për krijimin e prioriteteve, simulohet qendër tregtare dhe dyqane për veshje. Nxënësit shkojnë të blejnë veshje, dhe bëjnë zgjedhje, më pas prezantim të veshjes së blerë.</p> <p>Diskutim ku, çfarë do të zgjedhin për veshje? Sipas cilave kritere? (çfarë është e shëndetshme, çmimi, materiali, dizajni, ngjyra, trendi...)</p>

<p>- të mësojë si të kujdeset dhe ta mirëmbajë veshjen dhe këpucët e veta</p> <p>- të mësojë të zbatojë këshilla praktike për mirëmbajtjen e veshjes dhe këpucëve</p>	<p>- kujdes dhe mirëmbajtje i veshjes dhe këpucëve</p>	<p>Mjete për larje, Larje me dorë Larje me makinë Pastrim kimik Tharje Hekurosje – hekur, dërrasë për hekurosje Palosje, paketim Pastrim Ngjyrosje</p>	<p>- diskutim për mënyrat në të cilat kujdesemi për veshjen (paketim dhe pastrim i veshjes)</p> <p>- demonstrim dhe ushtrim i hekurit në pjesë të ndryshme të veshjes</p> <p>- demonstrim i llojeve të ndryshme të palosjes</p>
<p>- të mësohen aftësitë kryesore të qepjes me makinë, qepjes të nevojshme në jetën e përditshme</p> <p>- të fitojnë aftësitë bazë të qëndisjes</p>	<p>- mënyra të përpunimit të veshjes – përpunim me dorë dhe me makinë i veshjes</p> <p>- mënyra tradicionale dhe bashkëkohore të përpunimit</p> <p>- çfarë mund të bëj vet?</p>	<p>Me dorë, me marinë Qepje, prerje, thurje, qëndisje, tjerje...</p>	<p>- Në grupe lexohet dhe prezantohet për mënyrat e ndryshme të përpunimit të veshjes</p> <p>- diskutim për mënyrat tradicionale të përpunimit përball mënyrave bashkëkohore</p> <p>- mësim i aftësive bazë të qepjes (qepje, kopsë, qepje materiali të grisur), thurje, qëndisje...</p>
<p><b>Tema: SIGURI DHE MBROJTJE</b></p>			
<p>Nxënësi/nxënësja</p> <p>- të njihet me rreziqet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera</p> <p>- ti vërejë dhe shikojë burimet e kërcënimit</p>	<p>fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi dhe rreziqe të tjera; tërmet, përmytje, rrëshqitje të</p>	<p>Burime kanosjeje (tërmet, rrëshqitje toke, zjarre)</p> <p>Preventivë mbrojtje personale (vetëmbrojtje)</p>	<p>- Nxënësit i njohin, dallojnë dhe definojnë fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, vetëm në funksion të mbrojtjes personale.</p> <p>Aktivitetet mund të jenë punëtori, ushtrime, kabineti dhe në teren, varësisht nga kushtet dhe karakteristikat e shkollës dhe rajonit të cilit i përkasin.</p>

<p>në shkollë, në shtëpi dhe në rrethinë</p> <p>-të aftësohet të veprojë drejtë në gjendje të jashtëzakonshme;</p> <p>- Të mund të njoh shenja për rrezik dhe të veprojë drejtë në situata të jashtëzakonshme;</p> <p>- ta kuptojë domethënien e veprimit të drejtë dhe disiplinuar</p>	<p>tokës, mot i keq – shi, rrufe, dëborë, mjegull, erëra;</p> <p>-fatkeqësi – zjarre, fatkeqësi teknike etj.</p> <p>Preventivë dhe mbrojtje para, gjatë dhe pas fatkeqësisë.</p> <p>Veprime dhe rregulla për sjellje të drejtë nëpërmjet simulimit të ndonjë fatkeqësie të caktuar.</p> <p>Njohje të shenjave të rrezikut, numra të rëndësishëm, ku gjenden?</p> <p>Masa për siguri dhe mbrojtje.</p> <p>Evakuim, drejtime të lëvizjes dhe vend mbledhës në shkollë.</p> <p>Domethënia e evakuimit të drejtë në shkollë dhe shtëpi.</p>	<p>grupore (kolektive)</p> <p>Shenja për rrezik</p> <p>Sirenë numra thirrës telefoni</p> <p>195- (Qendra për menaxhimin e krizave) në RM.</p> <p>- Lista me numra të rëndësishëm</p> <p>- kryqi i kuq, policia, ndihma e shpejtë, Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim</p> <p>Siguri</p> <p>Evakuim</p> <p>Drejtimit – rutë e lëvizjes</p> <p>Vend mbledhës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përpunim të listave me numra të rëndësishëm dhe shigjeta të lëvizjes së klasës së vet për lëshim të shkollës. Posterët e përpunuar, skemat, vizatimet, shigjetat vendosen në vende të dukshme në shkollë – në derën e klasës, në korridore, nëpër shkallë etj.</li> <li>- Për ilustrim mund të përdoret film, CDrom, tekste, fotografi etj.</li> </ul> <p>Në teren dhe në shkollë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësit simulojnë, mapojnë vende të rrezikshme</li> <li>- gjendje krize, i ushtrojnë veprimet për mbrojtje dhe siguri;</li> <li>- ushtrim për evakuim (PARA, GJATË dhe PAS rrezikut)</li> <li>- punojnë në aktivitete hulumtuese të cilat karakterizojnë fundin e tyre – rrethimin, nënshtrim ndaj fatkeqësive dhe rreziqeve.</li> </ul>
---	---	---	--

Tema: Ndihma e parë			
<p>Nxënësi/nxënësj</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të dijë procedurën e thurjes së ndihmës së parë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Domethënia e ndihmës së parë</li> <li>- Mjete për tregimin e ndihmës së parë</li> <li>- vlerësim të më të rëndësishmit dhe thirrje e ndihmës së parë</li> </ul>	<p>Ndihma e parë Lëndim dhe i lënduar Rrezik për jetën</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- diskutime për situata në të cilat ka nevojë për ndihmë të parë, shembuj dhe eksperiencia.</li> <li>- Punëtori për miratimin e procedurës për thirrjen e ndihmës së parë (thirrje të ndihmës së parë mjekësore) nëpërmjet ushtrimit të procedurës së pyetjeve – ku? Çfarë? Sa? Cilat lëndime? Cili?</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të njihet me aftësitë bazë për dhënien e ndihmës së parë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- ndihma e parë në funksion të vetë ndihmës dhe ndihmë të lënduarit</li> <li>- procedurë për dhënien e ndihmës së parë</li> </ul>	<p>Procedura për tregimin e ndihmës së parë</p> <p>Shenja vitale ose shenja jete</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- definimin e procedurës së veprimeve për tregimin e ndihmës së parë të lënduarit nëpërmjet bisedës.</li> <li>- Demonstrim nga person profesionist për njohjen e teknikave të ndihmës së parë.</li> <li>- Punëtori me simulimin e llojeve të lënduarve dhe vendosjen e kontaktit verbal me përkrahje psikologjike të të lënduarit.</li> <li>- Formimin e posterit – informatorit me procedurën e veprimeve</li> </ul>

Tema: NXËNËSI SI KONSUMATOR

<p>Nxënësi/nxënësj</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të aftësohet të aftësojë buxhetin e vetë</li> <li>- të aftësohet për kursin – shpenzim të përgjegjshëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi si konsumator – të drejta dhe detyrime, konsumatorë të informuar</li> <li>- përgatitjen dhe drejtimin me buxhetin personal</li> <li>- çfarë është e ardhur, shpenzim dhe kursim</li> <li>- përcaktimin e prioriteteve në shpenzim</li> </ul>	<p>Konsumator Prodhim Shërbim</p> <p>Buxhet personal Buxhet mujor Buxhet familjar</p> <p>E ardhur Shpenzim Kursim</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Me shembuj të përditshëm stimulohen nxënësit të zbulojnë rrolin e veta si konsumatorë si edhe shfrytëzues të shërbimeve dhe bëhen të vetëdijshëm për rolin e vet aktiv në ato regata dhe konsumatorë të informuar.</li> <li>- Nxënësit i identifikojnë dhe definojnë termet nëpërmjet metodave të ndryshme, punëtorive, vizitë marketi, dentist, berberi – parukieri etj.</li> <li>- Mendojnë për atë ku dhe si i shpenzojnë paratë të cilat i fitojnë ose iu ka dhënë dikush</li> <li>- Nxënësit përmendin 10 prodhime dhe 10 shërbime që i përdorin në familje, dhe më pas i kualifikojnë sipas prioriteteve</li> <li>- Përgatitjen e tabelës për të ardhura, shpenzime dhe kursime</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- të njihet me elementet bazë e deklaratës së prodhimet dhe me domethënien e saj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- deklaratë – letërnjoftimi i prodhimet</li> </ul>	<p>Deklaratë e prodhimet</p> <p>Përbërja</p> <p>Afati i prodhimet</p> <p>Kohëzgjatja e prodhimet</p> <p>Sasia</p> <p>Prodhuesi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësit sjellin tre prodhime të paketuara nga i njëjti lloj – lëng, qumësht, çokolletë etj.</li> </ul> <p>Ato përcaktohen për prodhimin sipas paraqitjes – ambalazhit dhe formës.</p> <p>Bashkërisht shikojnë deklaratën.</p> <p>Diskutojnë, i lexojnë elementet e deklaratave të prodhimeve</p>

<p>- ta kuptojë nevojën (përfitimin) e llogarisë fiskale</p> <p>- të njihet me të drejtat si konsumator</p>	<p>Llogari fiskale</p> <p>Të drejta dhe detyrime të konsumatorit</p>	<p>CE-shenjë Simbole të tjera të shënimit</p> <p>Llogari fiskale</p> <p>Shenja për mbrojtjen e konsumatorëve të RM</p> <p>OPM-tel.023179-592 Inspektive (numra...)</p>	<p>Emri i prodhimit, data e prodhimit, afati i prodhimit, përbërja, sasia, pesha, prodhuesi, distributori etj. Mbi bazën e këtyre të dhënave, pjesëmarrësit sërish përcaktohen cilin prodhim do ta blinin Vijon distribucion, më pas përpunim të deklaratës – në tabelë ose poster, shkruhen elementet, mund përpunim i maketës – prodhim me deklaratë etj.</p> <p>- dramatizim: luajtjen e roleve – konsumator thes prodhim i dëmtuar, por nuk sjell llogari, ndërsa shitësi gjen një sër shkaqesh të mos e pranoj. Vijon diskutim për të drejtat edhe detyrimet e konsumatorëve</p> <p>- nxënësit ndahen në grupe. Çdo grup fiton nga një problem konsumator nga jeta e përditshme dhe nen nga Ligji ne të cilin rregullohet ai problem. Grupi studion problemin, i lexon të drejtat e konsumatorit në lidhje me problemin dhe shkruan zgjidhje të mundshme.</p>
---	--	--	--

<p>- Të njihet me termin reklamë e prodhimit</p> <p>- të zhvilloj raport kritik ndaj reklamës</p>	<p>Anë të mira dhe të dobëta të reklamës</p> <p>Reklama dhe mesazhet e saj</p>	<p>Reklama</p> <p>Marketingu</p>	<p>Për përgatitjen e temës shikojnë reklame dhe bëjnë përshkrim të tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nëpërmjet ideve të shumta të termit reklamë</li> <li>- Më pas nxënësit diskutojnë për elementet që mund të përdoren në një reklamë.</li> <li>- Vijon diskutim për elementet pozitive / negative të reklamës dhe ndikimin e saj mbi zgjedhjen e konsumatorit</li> <li>- Më pas diskutohet edhe për reklamën e fshehur për prodhime të cilat nuk duhet të reklamohen (cigaret, alkooli etj)</li> </ul>
---	--	----------------------------------	--

#### **4. REKOMANDIME DIDAKTIKE**

Realizimin e qëllimeve të lëndës mësimore *aftësi për jetesë* është kushtëzuar nga mënyra dhe qasjet e punës së mësuesit në klasë dhe në shkollë në përgjithësi. Të domosdoshme janë aktivitete të menduara dhe dizajnuara paraprakisht nëpërmjet të cilave do të vijnë në shprehje mundësitë individuale dhe aftësitë e nxënësit/nxënësës në lidhje me jetën e përditshme: qëndrim i sigurt në klasë dhe shkollë, në shtëpinë familjare dhe qëndrimi në rrethin më të gjerë, zgjedhje dhe përdorim i veshjes gjatë përfshirjes në aktivitete të ndryshme, ushqim përkatës.

Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet modeleve të punës në orë nëpërmjet të cilave nxënësi/nxënësja duhet të përdor aparate të thjeshta, vegla, materiale etj.

Kjo lëndë ofron mundësi për zhvillim të programeve dhe aktiviteteve që dalin nga specifikat e rrethimit të nxënësve që mund të shërbejë si burim dhe mjet për përfitimin e aftësive për zotërim më të shpejtë të njohurive nga rajonet e tjera programore, aktivitetet praktike dhe punimin me vegla për punë dhe vegla të thjeshta. Aktivitetet dhe përmbajtjet janë me të dhëna për korelatë me qëllimet e lëndëve: aftësi për jetë, arsim teknik, arsim figurativ si aktivitete të programuara hulumtuese në lëndët mësimore të sferës shoqërore dhe natyrore të programit.

Rekomandohet që mësuesi përshtyjë punën e pavarur të nxënësve, të përkrah kreativitetin dhe inventivitetin e tyre nëpërmjet teknikave të ndryshme të punës: ide të shumta, simulim të situatave, luajtjen e roleve, organizimin e punëtorive, përdorimin e eksperimentës së jetës së fëmijëve, zbatim dhe përdorim të tyre në zgjidhjen e problemeve të karakterit praktik që janë pjesë e programit të lëndës.

Koncepti programor i kësaj lënde mësimore mundëson kryerjen e aktiviteteve të ndryshme, diskutime në grup ose klasë në lidhje me barazinë dhe angazhimin e punës së djemve dhe vajzave në kryerjen e detyrave dhe detyrimeve të ndryshme.

Lënda mësimore aftësim për jetesë është përfshirë me 72 orë në vit dhe ka status të lëndës me zgjedhje që nxënësit mund ta zgjedhin në ciklin e fundit zhvillimor të arsimit bazë.

#### **5. VLERËSIM TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

Për realizim të suksesshëm të qëllimeve të kësaj lënde mësimore është e domosdoshme në kontinuitet të ndiqet puna e çdo nxënësi/nxënësë. Ndjekja e vazhdueshme është kushtëzuar nga pikëpamjet e eksperiencave paraprake, aftësive dhe njohurive paraprake me të cilat disponon çdo nxënës/nxënësë. Llojin dhe vëllimi i aktiviteteve mësuesi duhet ti programojë sipas mundësive individuale të cilat nxënësi/ nxënësja i demonstroi gjatë zhvillimit dhe realizimin e çdo aktiviteti.

Produkti final nga detyra e kryer nuk duhet të përfaqësoj ndikues të vetëm për vlerësim të përparimit. Vlerësimi i nxënësve duhet të lidhet me ndjekjen e vazhdueshme të mënyrës së kryerjes të aktiviteteve hulumtuese, prezantimin, bashkëpunimin në grupe, përdorimin përkatës së veglave etj.

Gjatë vitit mësimor nxënësi/nxënësja vlerësohet me nota.

## **6. KUSHTE AMBIENTI PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR**

Programi në lidhje me kushtet e ambientit bazohet në normativën për ambient, pajisje dhe mjete mësimore për shkollën me baza nëntëvjeçare të sjell nga ana e ministrit për arsim dhe shkencë me vendim nr. 07-1830/1 nga data 28.02.2008.

## **7. NORMATIVË PËR KUADËR MËSIMOR**

Mësues lënde në arsimin fillor me trajnim të përfunduar për realizimin e programeve.

## **8. REZULTATE TË PRITURA**

Nxënësi / nxënësja:

- i di rregullat për zgjedhje, mirëmbajtje dhe kujdesie të ushqimit
- di të përdor pajisjen për ushqim
- di të përgatis ushqim të thjeshtë sipas recetës së dhënë
- sillet në mënyrë sociale të pranueshme gjatë ngrënies
- di të zgjedh pajisje për ngrënie dhe vendosjen në tavolinë
- di rregulla të caktuara për veshje sipas aktiviteteve që i kryen
- di të përdor pajisje për qepje
- di të qep, të qep me gjilpërë, të thur në mënyrë të thjeshtë
- di të përgatis listë shpenzimesh nga buxheti personal sipas rasteve të nevojshme
- di rregulla dhe procedura për shmangien e rrezikut dhe/ose mbrojtje gjatë rrezikut
- e di domethënien e simboleve në deklaratat e prodhimeve që i blen
- mund të shikojë mesazhe të fshehura në reklama

## **9. PROGRAMIN MËSIMOR E PËRGATITI GRUPI PROFESIONIST**

1. Sofka Koceva, këshilltar në BZHA- koordinator
2. Prof. D-r Snezhana Adamçevska, Fakulteti filozofik – instituti i pedagogjisë – Shkup - Kryetar
3. Ana Blazheva, SUGS “Marija Kiri Sklodovska” - Shkup
4. Zhaneta Çonteve, koordinator i projektit nga UNICEF- Shkup
5. Marija Tanevska, Ministria e shëndetësisë - Shkup

## **10. VENDIM DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR**

Programin mësimor për lëndën Aftësi për jetesë për klasën e gjashtë të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e shtatë, tetë ose të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçar e solli

Ministri

\_\_\_\_\_

data \_\_\_\_\_

Sulejman Rushiti